

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.963/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.963/2021 të datës 24.11.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati

me adresë nga Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me numër Nr.ref:438/2021 të datës 11.11.2021 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike 'kërkesë nga marrëdhënia e punës', duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 19.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.ref:438/2021 i datës 11.11.2021 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- II. OBLIGOHET Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale ligjore për ta *rishqyrtuar* lëndën e ankuesit
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës sipas Akt emërimit të datës 05.09.2012 në pozitën "Zyrtar i lartë për marrëdhënie dypalëshe", ndërsa me datën 31.08.2021 Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerrë Vendim me numër Nr.Ref.293/2021 sipas të cilit vendim ankuesi me

gradë diplomatike Sekretar i Parë caktohet të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar nga data 01.10.2021 me mandat katër (4) vjeçar.

Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 11.11.2021 nxjerrë Vendim me numër Nr.Ref.438/2021, sipas të cilit ankuesin me gradën Sekretar i Parë e në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar e kthen/tërheq nga misioni diplomatik nga data 12.11.2021.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin e Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër Nr.ref:438/2021, te datës 11.11.2021 lidhur me tërheqjen dhe kthimin e tij nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Londër/ Mbretërinë e Bashkuar, me datën 24.11.2021 përmes përfaqësuesit të tij, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5640/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 30.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje ne ankesën e ankuesit tek Ministria e Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datën 21.12.2021, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 24.11.2021 me Nr.Prot:5640/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.Ref:438/2021 i datës 11.11.2021 nga Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme; Vendimin me numër Nr.Ref:293/2021 i datës 31.08.2021 nga Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme; Kërkesën e datës 28.10.2021 nga ankuesi për Zv. Sekretaren e Përgjithshme të MPJD-së; Kërkesën e datës 03.11.2021 nga ankuesi për Zv. Sekretaren e Përgjithshme të MPJD-së; Procesverbalin e datës 05.11.2021; E-mailin zyrtar te datës 17.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 09.11.2021; E-mailin zyrtar te datës 05.11.2021; Listën me e-mailat zyrtar të datës 17.11.2021 ndërmjet ankuesit dhe zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Akt emërimit e ankuesit të datës 05.09.2012; Vendimin me numër Nr.Ref: 092/2015 të datës 30.12.2015; Autorizim i datës 17.11.2021 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.11.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.12.2021 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me shkresat e bashkangjitura të lëndës ; Akt emërimit me numër AE.Nr.16/2021 të datës 19/02/2021; Vendimin me numër Nr.Ref:235/2021 nga Zv. Sekretarja e Përgjithshme e MPJD-se për ankuesin; Formularin -PDP mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 09.11.2021; Kërkesën e datës 18.10.2021 nga ankuesi për Zv. Sekretaren e Përgjithshme të MPJD-së; E-mailin zyrtar të datës 05.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 08.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 05.11.2021 lidhur me fotografitë për çmimet e banimit; Udhëzimin administrativ me numër Nr.01/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ Nr.03/2012 për shpenzimet personale dhe operacionale në misionet diplomatike dhe konsullore te Republikës së Kosovës; Udhëzimin administrativ me numër Nr.03/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrative me numër Nr.03/2012 për shpenzimet personale dhe operacionale në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* duke e obliguar Zëvendës Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të bëjë rishqyrtimin e Vendimit me numër Nr.ref:438/2021 të datës 11.11.2021 përmes të cilit ankuesi është kthyer / tërhequr nga misioni diplomatik , *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, se Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër Nr.ref:438/2021 të datës 11.11.2021 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që vendimi si i tillë nuk i plotëson kriteret e parapara formale të akti administrativ, mungon arsytimi, këshilla juridike dhe në vetvete është kundërthënës dhe i paligjshëm, po ashtu me pretendimin se vendimi fjalë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, si dhe Udhëzimit Administrativ me numër 03/2018 i datës 04.06.2018 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2012 për Shpenzimet Personale dhe Operacionale në Misionet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 11.11.2021 ka nxjerr Vendim me numër Nr.ref.438/2021 përmes të cilit,, Z. *me gradën Sekretar i Parë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar e kthen/tërheq nga misioni diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës , ndërsa ne paragrafin II të këtij vendimi citoj ,, Kthimi i i shprehur si në piken e 1 të këtij vendimi behet me datën 12.11.2021''* andaj Kolegji vlerëson se Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk ka arritur të arsyetojë vendimin siç përcaktohet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: *"Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave si dhe 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret"* sepse Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk ka arritur të sqarojë mjaftueshëm situatën faktike mbi bazën e së cilës është marrë vendimi, respektivisht të sqarojë shkaqet se për çfarë arsye behet kthimi i ankuesit nga misioni diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me urgjencë „brenda 24 orëve“, po ashtu nuk ka arritur të arsyetojë Vendimin në fjalë se pse në rastin konkret kanë qenë të pazbatueshme dispozitat e nenit 23 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se mungesa e arsytimit të pamjaftueshëm të Vendimit numër Nr.11/44 nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës është e barabartë me mungesën e tij siç përcaktohet me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafi 2 i cili përcakton se: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër Nr.ref.438/2021 i datës 11.11.2021, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e

Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1,1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafin 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike si dhe nuk përmban, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike)", siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ka konstatuar që me dispozitat e nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2018 të datës 04.06.2018 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2012 për Shpenzimet Personale dhe Operacionale në Misionet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës përcaktohet se,, Neni 4, paragrafi 10 i udhëzimit administrativë bazë ndryshohet si vijon: *"Kur në shtetin pritës kostoja e jetesës është më e lartë se kriteret përmes të cilave janë përcaktuar limitet e qirave të banimit në shtojcën 1, Sekretari i Përgjithshëm, pas konsultimit me Ministrin e Punëve të Jashtme mund të lejoj tejkalimin e këtij limiti për anëtarët e personelit diplomatik dhe konsullor ne vendet ne Grupin e Parë në shume të arsyeshme që përshtatet me nivelin e koston së jetesës në vendin e caktuar pritës"*, e që në rastin konkret ankuesi disa herë radhazi ka kërkuar nga ana e Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që t'i aprovojë tejkalimin e shpenzimeve për banim pasi që me limitin e lejuar ka pasur vështirësi të gjej banesë dy dhomëshe, pas ngritjes së çmimeve për patundshmëri pas pandemisë, konkretisht kërkesa i është bërë edhe me datë 05.11.2021 pas aprovimit nga ana e Komisionit shqyrtues për përzgjedhjen e hapësirës së banimit, po ashtu gjatë shqyrtimit të provave të lëndës Kolegji ka gjetur se me datë 09.11.2021 Shefja e misionit diplomatik të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Londër nëpërmjet e-mailit zyrtarë të dërguar tek Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me të cilin e ka sqaruar se si është vepruar „ për rastet e mëhershme në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër" andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit

Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është e obliguar që të vlerësoj të gjitha provat e bashkëngjitura të lëndës, duke marrë parasysh edhe e-mailin e datës 09.11.2021 të dërguar nga Shefja e misionit diplomatik të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar për Zëvendës Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe të konstatoj saktë nëse janë përdorur standarde të dyfishta nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme gjatë zbatimit të Udhëzimit administrativ lidhur me aprovimin apo mos aprovimin e tejkalimit buxhetor duke marrë parasysh kosoton e jetesese ne Londer dhe kriteret e percaktuara sipas ketij Udhezimi lidhur me shpenzimet e banimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Vendimi me numër Nr.ref:438/2021 i datës 11.11.2021 i Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurave administrative është i kundërligjshëm siç e përcakton Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konkretisht neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku thuhet se : *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative"*, andaj, nisur nga konstatimi i mësipërm, Kolegji vlerëson se të metat e tilla të aktit administrativ e bëjnë të paligjshëm Vendimin me numër Nr.ref.438/2021 të datës 11.11.2021 të Zëvendës Kryeministres dhe

Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe ekziston bazë e mjaftueshme që lënda e ankuesit respektivisht nxjerrja e vendimit për tërheqjen/ *kthimin nga misioni diplomatik ne Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës* të kthehet në rishqyrtim.


Duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që lënda të kthehet në rivendosje tek organi i njëjtë, gjegjësisht Ministria e Punëve të Jashtme e cila në procedurë të rishqyrtimit duhet t'i marrë parasysh pikëpamjet juridike dhe t'i eliminoj të metat e konstatuara sipas këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.963/2021

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Zv. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

